



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 29 ..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30/03/2022

**VENDIM**

Nr.05, date 30 /03/2022

**PËR**

**RREGULLOREN TEKNIKE PËR OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE KONTROLLIN  
E PAJSIJEVE DHE STRUKTURAVE NË KASKADËN E LUMIT DEVOLL**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.03.2022 mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë Devolli Hydropoëer për miratimin e Rregullores teknike të operimit, mirëmbajtjes dhe kontrollin e pajisjeve dhe strukturave në kaskadën e lumit Devoll. Antaret e pranishëm të KKDM diskutuan në lidhje me këtë kërkesë duke u bazuar në dokumentacionin teknik të paraqitur, në legjislacionin e mësipërm si dhe në faktin që KKDM ka aprovuar rregulloret teknike përkatëse për digat e Banjës dhe Moglicës me anë të Vendimeve respektive Nr. 05, datë 29.06.2018 dhe Nr.10, datë 21.12.2020. Pas diskutimeve të të gjithë antareve, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratojë kërkesën për miratimin e rregullores teknike për operimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e pajisjeve dhe strukturave në kaskadën e lumit Devoll
- 2- Ti kërkojë shoqërisë Devoll Hydropoëer sha
  - Të përditësoj rregulloret teknike për cdo digë të aprovuara me parë nga KKDM duke u bazuar në udhëzimet e dhëna nga KKDM pas aprovimit të këtyre rregulloreve sic janë udhëzimet në lidhje me monitorimin e digave pas rënies së një termeti, përgatitjen e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile si dhe situatën aktuale për monitorimin e këtyre digave.
  - Përditësimi i rregullores të bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi, udhëzimeve të mësipërme si dhe të rekomandimeve të ICOLD për menaxhimin e integruar të digave të një kaskade ku theksohet rëndësia e operimit optimal të integruar të rezervuareve të kasakdës si dhe përgatitja e moduleve të operimit duke kombinuar përfitimet nga hidroenergja me zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet dhe përfitimet nga ujitja e tokave në zonën e poshtme të kësaj kaskade.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

